

## **Bashkimet ndërmjet ndërmarrjeve – përqendrimet në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës**

Kapitulli i tretë i Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 145/10, 136/11, 41/2014, 53/16, 83/18 dhe “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” 208/24 dhe 16/25) (Ligji) i referohet kontrollit të përqendrimeve.

Ligji në këtë pjesë:

- definon se çfarë konsiderohet si përqendrim;
- definon kushtet të cilat duhet t’i plotësojnë përqendrimet për t’iu nënshtruar detyrimit për njoftim të detyrueshëm të përqendrimit te Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës (Komisioni);dhe
- definon kriteret në bazë të të cilave bëhet vlerësimi i përqendrimeve, gjegjësisht kriteret në bazë të të cilave Komisioni vendos nëse do ta lejojë ose do ta ndalojë përqendrimin.

### ***Çfarë konsiderohet si përqendrim sipas Ligjit?***

Në përputhje me nenin 12 të Ligjit, përqendrimi krijohet me ndryshimin e kontrollit në bazë afatgjatë.

Si përqendrim, gjegjësisht ndryshim i kontrollit në bazë afatgjatë në përputhje me Ligjin, konsiderohet:

- bashkimi i dy ose më shumë ndërmarrjeve të pavarura paraprakisht ose pjesëve nga ndërmarrjet;
- Fitimi i kontrollit të drejtpërdrejtë ose të tërthortë mbi të gjithë ose pjesë të një ose më shumë ndërmarrjeve të tjera nga një ose më shumë persona që tanimë kontrollojnë të paktën një ndërmarrje (në rastin kur kontrollin mbi një ndërmarrje e fiton një person fizik që tanimë ka kontroll mbi një ndërmarrje tjetër); ose
- Fitimi i kontrollit të drejtpërdrejtë ose të tërthortë mbi të gjithë ose pjesë të një ose më shumë ndërmarrjeve të tjera nga një ose më shumë ndërmarrje (fitimi i kontrollit të përbashkët konsiderohet gjithashtu përqendrim). Kur një ndërmarrje ka qenë nën kontrollin e vetëm të një personi, dhe pas transaksionit personi që ka pasur kontroll do të vazhdojë të ketë kontroll të përbashkët me një person tjetër, kjo gjithashtu konsiderohet si përqendrim. Kur një ndërmarrje ka qenë nën kontroll të përbashkët, dhe pas transaksionit një ndërmarrje e caktuar fiton kontroll të vetëm mbi të (përfshirë fitimin e kontrollit nga një person fizik që tanimë kontrollon një ose më shumë ndërmarrje), kjo gjithashtu konsiderohet si përqendrim, madje edhe në rastin kur personi që fiton kontrollin e vetëm më parë ka pasur kontroll të përbashkët.

### ***Mënyra e fitimit të kontrollit***

Fitimi i kontrollit mund të bëhet përmes blerjes së aksioneve, pjesëve, rritjes së kapitalit themelorë, blerjes së një pjese të pronës, me marrëveshje (e drejta e shfrytëzimit e të gjithë ose

një pjese të pronës së ndërmarrjes ose në bazë të të drejtave apo marrëveshjeve që ofrojnë mundësinë e ndikimit vendimmarrës mbi përbërjen, votimin ose marrjen e vendimeve nga organet e ndërmarrjes) ose në një mënyrë tjetër të parashikuar me ligj.

Krijimi i sipërmarrjes së përbashkët (joint venture), e cila në një bazë afatgjatë do të kryejë aktivitete në tërsinë ekonomike autonome, gjithashtu konsiderohet si përqendrim.

***Një përqendrim nuk konsiderohet kur:***

- 1) Bankat, kursimoret dhe institucionet e tjera financiare ose shoqëritë e sigurimit, aktivitetet e rregullta të të cilave përfshijnë punë juridike dhe tregtim me letra me vlerë, përkohësisht fitojnë letra me vlerë me qëllim që ato përsëri të shiten brenda një viti nga momenti i fitimit të tyre dhe nëse të drejtat e votës nga ato letra me vlerë nuk kryhen me qëllim që të ndikohet në sjelljen konkurruese të ndërmarrjes në treg.
- 2) Kontrolli kryhet nga ana e përfaqësuesit të shoqërisë në procedurë falimentimi ose në procedurë likuidimi.
- 3) Fondet e investimeve fitojnë interes kapital në ndërmarrjet, me kusht ato t'i realizojnë të drejtat e fituara vetëm me të vetmin qëllim që të ruhet vlera e plotë e investimit të tyre, dhe nëse nuk kryhet ndikim mbi sjelljen konkurruese të ndërmarrjeve në treg.
- 4) Ristrukturimi brenda një grupi nuk përbën përqendrim. Në përputhje me Ligjin, përqendrimi ekziston kur ka ndryshime në kontroll. Ristrukturimi i brendshëm brenda një grupi të ndërmarrjeve (të lidhura) nuk përbën përqendrim. Kjo vlen, për shembull, për rritjen e pjesës së aksioneve/pjesëve ku nuk ka ndryshime në kontroll ose për aktivitetet e ristrukturimit si bashkimi i ndërmarrjeve të lidhura, ose ndryshimi i kontrollit mbi ndërmarrjen, ndërsa fituesi i kontrollit është gjithashtu pjesë e grupit (ndërmarrje e lidhur/ndërmarrje udhëheqëse ose varur brenda të njëjtit grup të cilit i përket edhe ndërmarrja mbi të cilën fitohet kontrolli). Përqendrimi ndodh vetëm nëse transaksioni çon në një ndryshim në cilësinë e kontrollit në një ndërmarrje dhe si rrjedhojë nuk është më thjesht një ndryshim i brendshëm.

***A duhet për çdo përqendrim të parashtrohet detyrimisht njoftim te Komisioni?***

Nëse një transaksion i caktuar përbën përqendrim, pranë Komisionit detyrimisht dorëzohet njoftim vetëm nëse pjesëmarrësit në përqendrim plotësojnë një ose më shumë kushte të caktuara.

Sipas nenit 14 të Ligjit, një njoftim për përqendrim i dorëzohet Komisionit, nëse:

- 1) Të ardhurat vjetore të përgjithshme të përbashkëta të të gjitha ndërmarrjeve pjesëmarrëse, të realizuara nga shitja e mallrave dhe/ose shërbimeve në tregun botëror, e tejkalojnë shumën prej 10 milionë euro në kundërvlerë me denarë (në llogaritje merren parasysh edhe të ardhurat e realizuara në Republikën e Maqedonisë së Veriut) të realizuara në vitin afarist që i ka paraprirë përqendrimit, me ç'rast së paku një

pjesëmarrës doemos duhet të jetë i regjistruar në Republikën e Maqedonisë së Veriut; dhe/ose

- 2) Të ardhurat vjetore të përgjithshme të përbashkëta të të gjitha ndërmarrjeve të realizuara nga shitja e mallrave dhe/ose shërbimeve në Republikën e Maqedonisë së Veriut, e tejkalojnë shumën prej 2.5 milionë euro në kundërvlerë me denarë, të realizuara në vitin afarist që i paraprin përqendrimin; dhe/ose
- 3) Pjesëmarrja në treg e njërit prej pjesëmarrësve është më shumë se 40% ose pjesëmarrja e përgjithshme në treg e pjesëmarrësve në përqendrimin e tregut është më shumë se 60% në vitin që i paraprin përqendrimin.

***Si llogariten të ardhurat për të përcaktuar nëse përqendrimi i nënshtrohet detyrimit për njoftim?***

Në përputhje me nenin 16 të Ligjit, për qëllimet e zbatimit të nenit 14, të ardhurat të përgjithshme përbëhen nga shumat e realizuara nga shitja e mallrave të prodhuara në veprimtarinë e rregullt të ndërmarrjes, si dhe nga shumat nga shërbimet që ndërmarrja ofron në veprimtarinë e saj të rregullt, të realizuara në vitin afarist që i paraprin përqendrimin, pas heqjes së rabatit (lirimeve) të shitjes, tatimit mbi vlerën e shtuar dhe taksave të tjera publike të lidhura drejtpërdrejt me të ardhurat.

Nëse njëri prej pjesëmarrësve është ndërmarrje e lidhur, gjatë llogaritjes së të ardhurave të tij të përgjithshme, të gjitha ndërmarrjet që janë të lidhura në këtë mënyrë do të trajtohen si një ndërmarrje e vetme. (Të ardhurat të përgjithshme përfshijnë të ardhurat e ndërmarrjes që fiton kontrollin dhe të gjitha ndërmarrjet e saj udhëheqëse dhe të varura, si dhe ndërmarrjet udhëheqëse dhe të varura të tyre. Të ardhurat të përgjithshme të ndërmarrjes mbi të cilën fitohet kontrolli përfshijnë edhe të ardhurat e të gjitha ndërmarrjeve të saj të varura dhe të ndërmarrjeve të tyre të varura). Nëse kontrolli fitohet nga një person fizik, të ardhurat të përgjithshme përfshijnë të ardhurat të përgjithshme të ndërmarrjeve në pronësi të personit fizik dhe të gjitha ndërmarrjet e varura të atyre ndërmarrjeve.

Gjatë llogaritjes së të ardhurave të përgjithshme të ndërmarrjeve të lidhura, nuk merren parasysh shumat e realizuara nga shitjet e mallrave dhe/ose ofrimi i shërbimeve ndërmjet tyre.

Në rast kur përqendrimi i referohet fitimit të një pjese ose pjesëve të pronës së një ose më shumë ndërmarrjeve, pavarësisht nëse ato pjesë janë formuar si subjekte juridike të veçanta, gjatë llogaritjes së të ardhurave të realizuara nga ndërmarrja që e shet atë pronë, merren parasysh vetëm të ardhurat nga prona e cila është lëndë e fitimit.

Për bankat, kursimoret dhe institucionet e tjera financiare, të ardhurat e përgjithshme përcaktohen sipas të ardhurave të përgjithshme të realizuara nga veprimtaria e rregullt në vitin afarist që i paraprin përqendrimin.

Për shoqëritë e sigurimit, të ardhurat e përgjithshme përcaktohen sipas vlerës së premive të llogaritura bruto të pjesëmarrësve në vitin afarist që i paraprin përqendrimin.

### ***Kush ka detyrim të parashtrojë njoftim për përqendrim?***

Njoftimin për përqendrim e parashtron fituesi i kontrollit, ndërsa në rastin e fitimit të kontrollit të përbashkët, njoftimin e përbashkët e parashtrojnë fituesit e kontrollit të përbashkët. Kur ndërmarrja ka qenë nën kontrollin e vetëm të një personi, dhe pas transaksionit personi që ka pasur kontroll do të vazhdojë të ketë kontroll të përbashkët me një person tjetër ose me persona të tjerë, njoftimin e përbashkët e dorëzojnë të gjithë personat që do të kenë kontroll të përbashkët (duke përfshirë edhe personin që më parë ka pasur kontroll të vetëm).

### ***Kur parashtrohet njoftimi për përqendrim?***

Pjesëmarrësit në përqendrim janë të detyruar t'i dorëzojnë Komisionit njoftimin për përqendrimin para zbatimit të tij, ndërsa pas lidhjes së marrëveshjes për bashkim, marrëveshjes për fitimin e pjesëve, shpalljes së ofertës publike për blerje, etj., gjegjësisht pas miratimit të aktit nga i cili është qartë e dukshme qëllimi për të ndodhur përqendrimi si dhe struktura e përqendrimit.

Përqendrimi nuk duhet të zbatohet para se Komisioni të marrë një aktvendim me të cilin miratohet përqendrimi (përcaktohet se përqendrimi është në përputhje me Ligjin).

### ***Si parashtrohet njoftimi për përqendrim?***

Njoftimi për përqendrim parashtrohet në përputhje me Rregulloren për formën dhe përmbajtjen e njoftimit për përqendrim dhe dokumentacionin e nevojshëm që dorëzohet së bashku me njoftimin ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 44/12), e cila është gjithashtu e disponueshme në faqen e internetit të Komisionit [www.kzk.gov.mk](http://www.kzk.gov.mk).

### ***Çfarë ndodh nëse përqendrimi është zbatuar dhe nuk është parashtruar njoftimi?***

Nëse përqendrimi zbatohet para se të parashtrohet njoftimi dhe/ose para se Komisioni të marrë një aktvendim me të cilin e miraton atë, fituesit/ve të kontrollit do t'i shqiptohet një gjobë në një shumë deri në 10% të vlerës së të ardhurave të tyre totale vjetore, të llogaritura sipas nenit 16 të Ligjit.

Edhe pse Ligji për Mbrojtjen e Konkurrencës që nga viti 2005 përcakton detyrimin për ndërmarrjet, nëse plotësohen kushtet ligjore, të njoftojnë përqendrimin para zbatimit të tij, në vitin e kaluar Komisioni ka pasur një numër të shtuar të rasteve për të cilat ka zhvilluar procedurë dhe ka shqiptuar gjoba për përqendime të pa njoftuara, ku pjesëmarrësit në përqendrim kanë qenë ndërmarrje vendase. Me qëllim që të mos ndodhin shkelje të tilla të Ligjit në të ardhmen për shkak të mosnjohjes së mjaftueshme të ndërmarrjeve me detyrimin ligjor, Komisioni e konsideron të dobishme që, përmes këtij njoftimi të shkurtër, ndërmarrjet të njihen me detyrimet e tyre ligjore.

Për çdo përqendrim të pa njoftuar, për të cilin ka ekzistuar detyrimi të njoftohej Komisioni, Komisioni, si deri më tani, do të zhvillojë procedurë për kundërvajtje dhe do të shqiptojë gjobë, e cila sipas Ligjit është mjaft rigoroze, gjegjësisht deri në 10% të të ardhurave të ndërmarrjes

që ka pasur detyrim të dorëzojë njoftim (nëse ndërmarrja është pjesë e grupit, gjoba është deri në 10% e të ardhurave në nivel grupi) .

**Për të gjitha informacionet shtesë, Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës Ju qëndron në dispozicion.**

Kontakt:

Tel. 02 3298 666

e-mail: [kzk@kzk.gov.mk](mailto:kzk@kzk.gov.mk)

[valentina.nikolova@kzk.gov.mk](mailto:valentina.nikolova@kzk.gov.mk)